



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Kaçanik



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02 - 1419/21
Kaçanik, 14.01.2021

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 60/01-12895/20 të dt.30.06.202, e në mbështetje të nenit 11 të Rregullores 01Nr.02-04/26493/20 të dt. 23.11.2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Formohet komisionit për shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrohen kundër vendimit të vlerësimit të kërkesave nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim në këtë përbërje;

- 1.1 Zekir Selimi - Kryesues;
- 1.2 Shqipe Ceka - Anëtare;
- 1.3 Skender Sopa - Anëtare;
- 1.4 Jehona Dervishi - Anëtare;
- 1.5 Labinot Selmani - Anëtar;

3. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit për shqyrtimin e ankesave është që të vendos lidhur me ankesat e cila parashtrohet kundër procesit të vlerësimit të kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

4. Mandati i Komisionit është tre (03) vite ;

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e neshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-1395/21
Kaçanik, 14.01.2019

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 60/01-12895/20 të dt.30.06.202, e në mbështetje të nenit 10 të Rregullores 01Nr.02-04/26493/20 të dt. 23.11.2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, me këtë përbërje:
 - 1.1 Eljesa Begunca - Kryesuese;
 - 1.2 Rakip Vishi - Anëtar;
 - 1.3 Nebi Murseli – Anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform kësaj rregulloreje për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe t'i rekomandojnë Kryetarin e Komunës për nënshkrimin e kontratës.
3. Mandati i komisionit është tre (03) vite
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01-08Nr.104/02-1557/2.1
Kaçanik, 15.01.2021

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale. Rregulloren Komunale 2007/30. merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË
SHKAKTUARA NË BUJQËSI NGA FATKEQËSITË NATYRORE

I

Me këtë vendim formohet komisioni Komunal vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në territorin e Komunës së Kaçanikut me këtë përbërje:

1. Zylfi Koxha, Koordinator i sektorit të Bujqësisë
2. Arian Teneqja, zyrtar në DSHP
3. Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi dhe Blegtori

II

Komisioni ka për detyrë të dalë në teren, të verifikoj të gjitha dëmet e shkaktuara në Bujqësi, të bëjë vlerësim të dëmeve të shkaktuara për çdo ekonomi bujqësore me të cilën do të njoftoj Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Blegtori.


III

Me këtë Vendim njoftohen : Arkivi I Komunës, DBZHRP-së, dhe anëtarët e komisionit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



07-464/ 01-30640/20
Kačanik, 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 2, nenit 8, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së palujtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 13 dhe 58 Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/ 15 Qershor 2008), nenit 6.2 shkronja a) dhe h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe kërkesës për Shpronësim të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, më datë 21.01.2021 merr këtë:

V E N D I M


I. MIRATOHET kërkesa për iniciimin e procedurës për shqyrtim të metejshëm Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit për shpronësim të pronës së palujtshme, pra për pjesën e parcelës nr 00494-15, me sipërfaqe prej 253 m2, Zona Kadastrale Kačanik e evidentuar në emër të Amer (Shaqir) Shurdhani nga Kačaniku e cila ndërlidhet me projektin; Zgjerimi dhe ndërtimi i segmentit rrugorë të rrugës "Ismail Raka" në Kačanik.

II. Vlera e kompenzimit të pasurive të palujtshme të theksuara më lartë do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përfitojnë pronarët dhe zotëruesit e interesit, të cilët preken nga procesi i shpronësimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës-Komisioni i vlerësimit dhe do të kompenzohen nga ana e Komunës së Kaçanikut.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

IV. Vendimi hyne në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetatat me tirazh të madh.

I dërgohet: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
Arkivit të Komunës dhe Web faqës së Komunës.



Lista e parcelave kadastrale të parapara për shpronësim për projektin e ndërtimit të një pjese të rrugës " Ismail Raka " në Kaçanik.

Numri rendor	Emri dhe mbiemri i pronarit	Numri i parcelës	Kultura	Klasa	Zona kadastral e	Sip. e përgjith. (m ²)	Shpronësimi sipas projektit				
							Kultura	Klasa	Sip. për shpronësim	Sendet aksesore	Vërejtje
1	Amer (Shaqir) Shurdhani	494-15	arë	4	Kaçanik	1070 m ²	arë	4	253 m ²	-	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-1845 /21
Kaçanik, 19.01.2021

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 060/01-22954/20 si dhe nenit 14, 15 të Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për Ndarjen e Bursave dhe Caktimin Kriterëve për Vitin Akademik 2020-2021

1. Me këtë Vendim caktohen kushtet për aplikim, kriteret e përzgjedhjes, kohëzgjatja e realizimit të bursave, lartësia dhe numri i përfituesve të bursave.
- 2.. Për vitin akademik 2020-2021, Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për student të studimeve themelore universitare, në shumën 40 € në muaj (për 10 muaj).
3. Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kriterë:
 - 3.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
 - 3.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
 - 3.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
 - 3.4 të jenë student të vitit të dytë e më lartë,
 - 3.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
 - 3.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor).
4. Nga një familje mund të përfitoj vetëm një student, ndërsa përfitues do të jetë ai student që ka notën mesatare më të lartë.
5. Studentët të cilët i plotësojnë kriteret nga pika 3 e këtij vendimi, gjatë aplikimit duhet t'i paraqesin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kritereve:

6.1 Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10,

6.2 Studentët të cilët i takojnë kategorive të dala nga lufta (fëmijët e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të luftës), u shtohen 2 pikë,

6.3 Studentët me gjendje të rëndë ekonomike dhe` studentë me aftësi të kufizuara, u shtohen 2 pikë dhe

6.4 Dy e më shumë studentë nga një familje, u shtohen 1 pikë.

7. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

8 . Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

9. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës;
z. Besim Ilazi

